

Diplomati austriak
Wolfgang Petritsch: Thaçi
është vërtet fytyra
ndërkombëtare e UÇK-së

FACE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PDK-ja DORËZON NË KUVEND PROJEKTLIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA

FACE 4-5

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka bërë me dije të hënën se grupi parlamentar i kësaj partie ka proceduar në Kuvendin e Kosovës projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë. Hamza në një konferencë për media, ka thënë se Gjykata Speciale është

themeluar për të hetuar pretendimet e raportit të Dick Martyt, prandaj ajo duhet t'i kthehet mandatit mbi të cilin është krijuar. Ai ka theksuar se iniciativa nuk synon mbylljen e Dhomave të Specializuara, por përcaktimin më të qartë të mandatit dhe juridiksionit të tyre, duke i lidhur ato me pretendimet për të cilat, sipas PDK-së, ishte krijuar ky mekanizëm



STUDENTËT KËRKOJNË LIRIMIN E ISH-KRERËVE TË UÇK-së: NUK KA VENDIM QË NDRYSHON MËNYRËN SI I SHOHIM ÇLIRIMTARËT TANË

OPINION

NEVOJA EMERGJENTE PËR
NJË DISKURS TË RI POLITIK
DHE SHTETËROR F. 7

Shkruan:
Hajdin ABAZI



AKTUALE



NJË CISTERNË GODITET NGA NJË
PREDHË NË NGUSHTICËN E
HORMUZIT F. 7

DELEGACIONI I GRUPIT TË MIQËSISË
FRANÇË - BALLKANI PERËNDIMOR
NË PRISHTINË, DISKUTOHET PËR-
JEKJA E KOSOVËS PËR ANËTARËSIM
NË BE DHE NATO F. 7

KURTI NGA SHBA-TË: MËRGATA
DIKUR SAKRIFIKONTE PËR
KOSOVËN, SOT MUND TË INVESTOJË
PËR TË FITUAR F. 7


EKONOMI

AKB-ja NË ILO NË GJENEVË: KOSOVA
ENDE PA ZË NË ORGANIZATËN
BOTËRORE TË PUNËS

F. 8

TREGTIA ME PAKICË RRIKET 15.46%
NË MUJIN KORRIK F. 8

SPORT



FODA: DO TA JAPIM MAKSIMUMIN
NË KËTO KATËR NDESHJE TË LIGËS
SË KOMBEVE F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

NJË CISTERNË GODITET NGA NJË PREDHË NË NGUSHTICËN E HORMUZIT

TEHRAN, 21 SHTATOR - Një anije që po kalonte nëpër Ngushticën e Hormuzit u godit "nga një predhë e panjohur", duke plagosur dy anëtarë të ekuipazhit, tha një agjenci britanike detare. "Autoritetet ushtarake kanë uniformuar UKMTO-in se një cisternë që po kalonte u godit nga një predhë e panjohur", tha agjencia e Mbretërisë së Bashkuar për Operacione Tregtare (UKMTO) më 21 shtator. Sipas kësaj agjencie, dy anëtarë të ekuipazhit kanë pësuar lëndime të lehta dhe

"raportohet se anija ka vazhduar lundrimin drejt portit më të afërt". "Anijet këshillohen të kalojnë me kujdes dhe të raportojnë çdo aktivitet të dyshimtë te UKMTO-ja", paralajmëroi agjencia. Njoftimi vjen një ditë pasi kryenegociatori iranian, njëherësh kreu i Parlamentit, Mohammad Baqer Qalibaf, tha se Teherani ia ka përcjellë, përmes ndërmjetësve, Uashingtonit kushtet për përfundimin e bllokadës në Ngushticën e Hormuzit. "Mesazhi ynë dhe shpjegimi

qartësisht i është dërguar palës tjetër përmes ndërmjetësve", tha ai për televizionin shtetëror iranian. Ai shtoi se Ngushtica e Hormuzit nuk do të rikthehet në statusin para se të nisnin negociatat derisa Uashingtoni të plotësojë kushtet e Iranit dhe të përmbushë zotimet e tij. Ngushtica e Hormuzit është rrugë kyç për dërgesat detare pasi para se të niste lufta në fund të shkurtit mes Iranit dhe SHBA-së, nëpër këtë rrugë ujore kalonte rreth një e pesta e dërgesave botërore të naftës dhe gazit.



RUSIA SHPALL FITOREN REKORDE TË PARTISË SË PUTINIT, BE-JA KRITIKON ZGJEDHJET

MOSKË, 21 SHTATOR - Zyrtarët në Moskë kanë njoftuar një fitore të re rekorde për partinë Rusia e Bashkuar, të presidentit Vladimir Putin, në atë që Bashkimi Evropian i cilësoi si "zgjedhje farsë" më 21 shtator. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tha se Rusia e Bashkuar mori gati 58 për qind të votave, duke fituar 355 nga 450 ulëset në Dumën Shtetërore, në zgjedhjet e para për këtë institucion që nga nisja e pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës nga Rusia në vitin 2022. Në një proces të menaxhuar në mënyrë të rreptë më 18-20 shtator, votuesit mund të zgjidhnin mes disa partive që të gjitha janë të miratuara nga Kremli dhe mbështesin plotësisht Putinin. Rezultatet treguan se dhjetëra veteranë ushtarakë të luftës në Ukrainë tani do të jenë deputetë. E vetmja parti që kundërshton luftën në Ukrainë, Yabloko, u përjashtua nga zgjedhjet. Lideri i saj, Nikolai Rybakov, shkroi "për paqe" në fletën e



votimit me një marker të ndritshëm dhe pozoi me të për fotografët në një qendër votimi në Shën Petersburg.

Pjesa më e madhe e opozitës politike të Rusisë tani ndodhet në burg ose në mërgim. Dmitry Gudkov, i cili bën pjesë në

grupin e dytë, i tha Current Time se "nuk lejuan askënd [nga opozita] të kandidonte, dëbuan vëzhguesit zgjedhorë, kishte qartazi falsifikim të gjerë të votave". Gudkov është anëtar i Russian Democratic Forces, një grup opozitar në mërgim në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE). Ai tha se besonte se së shpejti ajo do t'i shpallte zgjedhjet për Dumën të paligjshme. Shefja e politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas, tashmë i ka cilësuar ato si të tilla, duke vënë në dukje, ndër të tjera, se votimi u zhvillua edhe në zonat e Ukrainës të pushtuara nga Rusia. "Zgjedhjet e ashtuquajtura për Dumën shënuan një tjetër goditje të madhe për demokracinë ruse", shkroi ajo në një postim në rrjetet sociale më 21 shtator. "Fasada e demokracisë është e vetmja gjë që ka mbetur në Rusi. Kam propozuar masa kundër atyre që mundësojnë këto zgjedhje farsë në territoret e pushtuara ukrainase."

Pjesëmarrja u raportua në 59.32 për qind, një rritje krahasuar me vitet e mëparshme, të cilën kryetarja e Komisionit Zgjedhor, Ella Pamfilova, e vuri në pah. Herën e fundit, në vitin 2021, pjesëmarrja ishte 51.7 për qind, ndërsa në vitin 2011 - kur akuzat për mashtrim zgjedhor çuan në protesta të mëdha të opozitës në Moskë, të cilat u shtypën brutalisht nga forcat e sigurisë - shifra ishte 60.2 për qind. Megjithatë, besueshmëria e shifrave zyrtare është vënë gjerësisht në pikëpyetje, ndërsa shembuj si Çeçenia - ku udhëheqësi i kahershëm i rajonit, Ramzan Kadyrov, u raportua se kishte marrë 99.85 për qind të votave - shihen si veçanërisht të dukshëm. "Në Çeçeni, nuk bëhet fjalë as për falsifikim masiv. Askush nuk i numëron fare votat", i tha Current Time Maksim Glikin, kryeredaktor i botimit në mërgim Mozhem Obyasniti. "Ata thjesht i shkruajnë shifrat e kërkuara dhe i publikojnë."

SHBA KA DEPORTUAR MBI 25 MIJË MIGRANTË NË VENDE TË TRETA

UASHINGTON, 21 SHTATOR - Që nga marrja e detyrës nga Donald Trump në janar 2025, administrata amerikane ka lidhur marrëveshje me vende të ndryshme për të pranuar migrantë që nuk mund të deportohen drejtpërdrejt në vendet e tyre të originës. Sipas një hetimi të Forbidden Stories dhe një konsorciumi gazetarësh ndërkombëtarë, deri më 31 gusht 2026, të paktën 25,447 persona janë deportuar në vende të treta. Rreth 20 mijë prej tyre janë dërguar në Meksikë, ndërsa të

tjerët në vende të Afrikës, Amerikës Latine dhe Paqësorit. SHBA-ja ka parashikuar rreth 410 milionë dollarë për këto marrëveshje. Një pjesë e fondeve u jepet drejtpërdrejt qeverive pritëse, ndërsa pjesa tjetër kalon përmes organizatave të OKB-së që merren me migracionin dhe refugjatët. Marrëveshjet ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Për shembull, Palau ka rënë dakord të pranojë deri në 75 persona në këmbim të 7.5 milionë dollarëve, ndërsa

Eswatini ka pranuar persona, përfshirë edhe disa me precedentë penalë. Hetimi ngre shqetësime për të drejtat e migrantëve, pasi shumë prej tyre dërgohen në vende me të cilat nuk kanë lidhje. Avokatët paralajmërojnë se disa prej tyre mund të përfundojnë në një "boshllëk ligjor", pa status të qartë dhe me mbrojtje të kufizuar. Sipas raportit, SHBA-ja ka kontaktuar 49 nga 54 vendet afrikane për të shqyrtuar mundësinë e pranimi të migrantëve të deportuar.



DIPLOMATI AUSTRIAK WOLFGANG PETRITSCH: THAÇI ISHTE VËRTET FYTYRA NDËRKOMBËTARE E UÇK-së

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Wolfgang Petritsch, ish-i dërguari i posaçëm i BE-së për Kosovën gjatë luftës, ka folur për rolin e Hashim Thaçit në UÇK dhe për përvojën e tij nga negociatat e viteve 1998-1999, pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara në Hagë.

Në një intervistë për gazetën gjermane "Frankfurter Allgemeine Zeitung", Petritsch, i cili ishte ndër diplomatët perëndimorë që e njihnin nga afër Thaçin gjatë luftës në Kosovë, është ndalur në çështjen e zinxhirit komandues të UÇK-së, marrëdhëniet e Thaçit me komandantët lokalë dhe negociatat për përfundimin e luftës.

Duke folur për aktgjykimin, Petritsch tha se një prej pyetjeve kryesore gjatë gjithë procesit gjyqësor ishte nëse UÇK-ja kishte pasur një zinxhir funksional komandues.

FAZ: Petritsch, si i dërguar i posaçëm i BE-së për Kosovën, ju ishit ndër personat e pakët që në vitet 1998 dhe 1999 e njohët personalisht udhëheqësin gueril kosovar, Hashim Thaçi. A ju befasoj aktgjykimi?

Petritsch: Pyetja kryesore përgjatë gjithë procesit ishte: A ekzistonte në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, UÇK, një zinxhir funksional komandues apo jo? Prokuroria pretendonte se ai ekzistonte, dhe se për këtë arsye Thaçi, si udhëheqës politik i UÇK-së, mbante përgjegjësi përfundimtare për krimet që i viheshin në barrë asaj. Mbrojtja argumentonte se UÇK-ja kishte qenë një trupë fshatare e mbledhur kuturu, raportet e pushtetit të së cilës ndryshonin nga lugina në luginë e nga rajoni në rajon. Sipas saj, Thaçi ishte vërtet fytyra ndërkombëtare e UÇK-së, por në zonat e veçanta luftarake nuk kishte asnjë fjalë vendimtare. Paraqitja e mbrojtjes me sa duket nuk i bindi gjyqtarët. Do të shohim nëse kjo do të qëndrojë edhe në procesin e apelit.

FAZ: Përpara luftës së NATO-s kundër Serbisë dhe gjatë saj, ju keni negociuar shpesh me Thaçin. Çfarë përshtypjeje kishit për të?

Petritsch: Ishte shumë i ri, as 30 vjeç nuk i kishte mbushur. Në krahasim me presidentin jugosllav Slobodan Millosheviq, një politikan i regjuri e me përvojë të thellë, ky ishte natyrisht një ndryshim i madh. Por ne ndërmjetësve perëndimorë shpejt na u bë e qartë përse



pikërisht ai po e udhëhiqte delegacionin negociator kosovar.

FAZ: Përse?

Petritsch: Pavarësisht moshës së re, Thaçi kishte inteligjencën politike që i nevojitej situatës së asaj kohe. Për mua, për më tepër, fakti që pikërisht Thaçi ishte njeriu kyç në palën kosovare kishte edhe një avantazh tjetër. Ai praktikisht nuk fliste fare anglisht, por fliste një gjermanisht mjaft të pranueshme, pasi kishte studiuar për një kohë të shkurtër në Zvicër. Kjo më mundësoi mua, si kryenegociator i BE-së, një qasje të drejtpërdrejtë me të, të cilën kolegët e mi amerikanë dhe rusë nuk e kishin.

FAZ: Aktakuza e Gjykatës Speciale të Kosovës e ngarkon Thaçin me krime lufte. Ai thuhet se mban përgjegjësi për faktin se në kampet e të burgosurve u torturuan dhe në disa raste u vranë serbë, por edhe shqiptarë të Kosovës. A kishite të dhëna për krime të tilla në vitin 1999?

Petritsch: Në atë kohë nuk kisha dëgjuar asgjë lidhur me këtë. Nuk duhet harruar konteksti i asaj kohe: Forcat serbe të sigurisë po kryenin krime të tmerrshme ndaj popullatës civile në Kosovë. UÇK-ja kishte lindur si reagim ndaj kësaj. Ajo ndërmernte sulme ndaj policëve serbë, ushtarëve

dhe përfaqësuesve të tjerë të Beogradit. SHBA-ja dhe BE-ja madje ishin fare pranë shpalljes së UÇK-së si organizatë terroriste. Kjo do t'i kishte vështirësuar jashtëzakonisht negociatat e çfarëdollojshme. Prandaj ishte shumë e rëndësishme që Thaçi dhe UÇK-ja të përfshiheshin sa më parë në bisedime politike, në mënyrë që të mos fundoseshin në një spirale të pazgjidhshme dhune si ajo e Lindjes së Mesme.

FAZ: Si u përpoqët ta arrinit këtë?

Petritsch: U shpjegova ministrave të jashtëm evropianë se shpallja e UÇK-së si organizatë terroriste nuk mund të ishte në interes të BE-së, nëse donim të zhvillonim bisedime për t'i dhënë fund gjakderdhjes. Ky argument i bindi ata. Amerikanët arritën në përfundime të ngjashme. Gjatë negociatave në Rambouillet të Francës, me anë të të cilave synohej shmangia e luftës në minutën e fundit, ministri i jashtëm gjerman Joschka Fischer dhe unë u ulëm në dhomën time dhe iu lutëm me këmbëngulje Thaçit që patjetër t'i nënshkruante propozimet perëndimore, sepse vetëm atëherë mund ta ndihmonim. Në thelb bëhej fjalë që shteti serb, pra ushtria jugosllave dhe njësitë speciale të policisë, të tërhiqnin të gjithë personelin nga Kosova,

nëse UÇK-ja do të pranonte shpërbërjen dhe çarmatimin e saj.

FAZ: Cili ishte qëndrimi i Thaçit ndaj kësaj?

Petritsch: Kisha përshtypjen se ishte i ngjirë nga frika. Si gjithnjë, ishte tejet i përqendruar dhe përgjigjej vetëm me fjali të shkurtra e të përmbledhura. Por ai druante se një vendim i gabuar mund t'i kushtonte me jetë në Kosovë. Do ta eliminonin. Atij i duhej të konsultohet vazhdimisht me njerëzit në Kosovë për të parë se sa larg mund të shkonte në bisedime. Vetë ai e dinte se pas shpërbërjes së UÇK-së do të mund të hynte në politikë. Por cili ishte qëndrimi i luftëtarëve të ndryshëm lokalë, të cilët nuk shihnin një mundësi të tillë?

FAZ: Në gjyqin e Thaçit shtrohej pyetja nëse ekzistonte një zinxhir funksional komandues në UÇK - pra nëse Thaçi në krye kontrollonte edhe komandantët rajonalë. Cila ishte përshtypja juaj atëherë?

Petritsch: UÇK-ja bënte përpjekje të mëdha për t'u paraqitur para nesh si një trupë ushtarake apo paraushtarake e organizuar mirë dhe me një hierarki strikte. Por përshtypja që ajo dëshironte të krijonte nuk përkonte domosdoshmërisht me realitetin. Madje as pala

serbe nuk e besonte këtë.

FAZ: Megjithatë, ju keni negociuar një herë për një shkëmbim të burgosurish, ku fjalën e fundit e pati Thaçi.

Petritsch: Kjo ndodhi në dimrin e viteve 1998/1999. UÇK-ja kishte zënë robër disa dhjetëra ushtarë serbë. Pala serbe kërkonte një shkëmbim të burgosurish, por ngulmonte që në asnjë mënyrë kjo të mos dukej si shkëmbim. Kushti i Beogradit ishte: Fillimisht duhet të liroheshin ushtarët serbë. Vetëm rreth dy javë më vonë, në një zhvillim në dukje të palidhur me këtë, do të lirohej i njëjti numër luftëtarësh të UÇK-së. Dhe kështu ndodhi.

FAZ: Çfarë roli luajti Thaçi në këtë mes?

Petritsch: Ne kishim negociuar renditjen e hapave me komandantët lokalë të UÇK-së, por më pas ata thanë se tani duhej të jepte miratimin edhe Thaçi, përndryshe marrëveshja nuk do të ishte e vlefshme. Ata arritën të lidheshin me të me telefon dhe ai ra dakord.

FAZ: Pra asgjë nuk bëhej pa Thaçin?

Petritsch: Kjo nuk mund të thuhet kështu. Bisedimet e përmendura u zhvilluan në luginën e Drenicës, bastionin e Thaçit. Vetëm pak fshatra më tutje, ai me shumë gjasë nuk do të kishte luajtur asnjë rol në bisedime të ngjashme. UÇK-ja ishte një organizatë heterogjene. Për shembull, udhëheqësin rajonal të UÇK-së, Ramush Haradinaj, i cili pas luftës u bë kryeministër i Kosovës, nuk e njihja fare. Në atë kohë nuk kisha dëgjuar kurrë për të.

FAZ: Rasti me gjasë do të shkojë në apel. Çfarë prisni nga kjo?

Petritsch: Nga proceset e tjera për krime lufte lidhur me ish-Jugosllavinë e dimë se aktgjykimet e shkallës së parë mund të përmbysen krejtësisht në procedurën e apelit - shih rastin e gjeneralit kroat Ante Gotovina. Ai u dënua nga Tribunali i OKB-së për Krime Lufte në ish-Jugosllavi me 24 vjet burg në shkallë të parë. Në procedurën e apelit, më pas u shpall i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës. Kjo nuk do të thotë se një përmbysje e tillë duhet patjetër të përsëritet në rastin Thaçi. Por, aktgjykimi i sotëm nuk ishte domosdoshmërisht fjala e fundit.



STUDENTËT KËRKOJNË LIRIMIN E ISH-KRERËVE TË UÇK-së: NUK KA VENDIM QË NDRYSHON MËNYRËN SI I SHOHIM ÇLIRIMTARËT TANË

**EPOKA
E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Studentët e Universitetit të Prishtinës kanë protestuar të hënën shesheve të Prishtinës me pankarta dhe parulla në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së dhe kundër vendimit të Gjykatës Speciale, e cila dënoi me 81 vjet burgim Hashim Thaçinin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin. Kësaj proteste i është bashkuar edhe djali i Jakup Krasniqit, Altin Krasniqi dhe djali i Salih Mustafës. Në pankartat e protestuesve studentë shkruhej "Jo në emër të studentëve", "Çlirimtarë nuk jeni vetëm, studentët janë me ju", "Në emër të popullit të Kosovës, lirojini", ndërsa u kërkuar që lufta çlirimtare të mos barazohet me krimet individuale. Studenti Donart Humolli, gjatë marshit të studentëve, ka thënë se rinia e Kosovës nuk pranon atë që e konsideron gjykim të padrejtë ndaj atyre që, sipas tij, mundësuan lirinë e vendit. Humolli ka deklaruar se nuk ka gjykatë apo vendim që do ta

ndryshojë mënyrën se si rinia e Kosovës i sheh çlirimtarët, duke theksuar edhe rëndësinë e mbështetjes së aleatëve ndërkombëtarë në çlirimin e Kosovës. "E kuptojmë se jemi fatlumë që bëjmë pjesë ndër brezat e parë të këtij kombi që e shijoi lirinë, pa e përjetuar tmerrin e luftës. Por po ashtu, e kuptojmë qartë se kjo liri nuk do të ishte e mundur pa sakrificën e ushtrisë çlirimtare të Kosovës", tha ai, duke shtuar se liria nuk do të ishte e mundur as pa mbështetjen e aleatëve tanë ndërkombëtarë, veçanërisht Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Sot, studentët dhe rinia e Kosovës qëndrojnë të bashkuar me besimin e patundur tek Perëndimi. Ashtu siç Perëndimi nuk e lejoi padrejtësinë në vitet '98 dhe '99, por u bë aleat i UÇK-së, për të sjellë lirinë, ashtu besojmë se do të mbetet aleat edhe sot, duke mos lejuar asnjë padrejtësi ndaj vetë aleatit të tij, luftëtarëve të UÇK-së", tha ai. Humolli ka thënë se rinia e Kosovës sot jeton në një shtet të



pavarur, demokratik dhe multietnik, duke theksuar se përvoja e popullit të Kosovës me shtypjen dhe padrejtësinë, sipas tij, e bën të papranueshëm një trajtim të tillë ndaj të tjerëve. "Rinia e Kosovës sot jeton e lirë në një shtet të pavarur, demokratik dhe multietnik. Duke respektuar e mbrojtur të gjitha minoritetet në Kosovë, një popull që ka qenë i shtypur për vite me radhë e di mirë se çfarë do të thotë ta përjetosh padrejtësinë, prandaj nuk ia dëshirojmë atë askujt, prandaj nuk pranojmë asnjë gjykim të padrejtë apo dënues ndaj atyre që na e mundësuan këtë liri. Përmes këtij mesazhi, dua t'ju drejtohem si atyre që sot ndodhen padrejtësisht në Hagë ashtu edhe të gjithë botës demokratike, nuk ka gjykatë e as vendim që do ta ndryshojë mënyrën se si rinia e Kosovës i sheh çlirimtarët tanë", tha ai. Ndaj vendimit të Gjykatës Speciale është duke u protestuar në gjithë Kosovën dhe në vendet evropiane, ku jetojnë bashkatdhetarët tanë deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



PDK-ja DORËZON NË KUVEND PROJEKTLIGJIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka bërë me dije të hënën se grupi parlamentar i kësaj partie ka proceduar në Kuvendin e Kosovës projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë. Hamza në një konferencë për media, ka thënë se Gjykata Speciale është themeluar për të hetuar pretendimet e raportit të Dick Martyt, prandaj ajo duhet t'i kthehet mandatit mbi të cilin është krijuar. Ai ka theksuar se iniciativa nuk synon mbylljen e Dhomave të Specializuara, por përcaktimin më të qartë të mandatit dhe juridiksionit të tyre, duke i lidhur ato me pretendimet për të cilat, sipas PDK-së, ishte krijuar ky mekanizëm

plotësimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Hamza ka theksuar se iniciativa nuk synon mbylljen e Dhomave të Specializuara, por përcaktimin më të qartë të mandatit dhe juridiksionit të tyre, duke i lidhur ato me pretendimet për të cilat, sipas PDK-së, ishte krijuar ky mekanizëm. "Specialja nuk mbyllet, por i kthehet mandatit për të cilin është krijuar. Projektligji përcakton që Dhomat e Specializuara të merren me pretendimet konkrete që lidhen me Raportin e Dick Martyt. Çështjet që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë mandat do të trajtohen nga institucionet kompetente të drejtësisë së Republikës së Kosovës. Asnjë rast nuk mbyllet - dosjet, provat dhe procedurat transferohen dhe vazhdojnë në Kosovë", ka thënë Hamza.

Kryetari i PDK-së ka theksuar gjithashtu se projektligji kërkon që juridiksioni i Dhomave të Specializuara të argumentohet konkretisht për çdo të akuzuar dhe për secilën pikë të aktakuzës. "Nuk duhet të mjaftojë një lidhje e përgjithshme me luftën apo me UÇK-në. Për çdo të akuzuar dhe për çdo pikë të aktakuzës duhet të argumentohet qartë pse ajo çështje i përket mandatit të posaçëm të Dhomave", ka deklaruar Hamza. Sipas tij, një tjetër element i rëndësishëm i projektligjit është

ritja e transparencës dhe llogaridhënies përmes monitorimit ndërkombëtar. "Projektligji parasheh mundësinë që organizata ndërkombëtare profesionale dhe të pavarura të monitorojnë respektimin e të drejtave të të akuzuarve, kohëzgjatjen e proceseve, kushtet e paraburgimit dhe standardet e gjyqësorë, por siguron më shumë transparencë dhe raportim para Kuvendit dhe publikut", ka përfunduar Hamza.

Pas këtij vendimi, PDK-ja ka paralajmëruar se, krahas hapave të tjerë demokratikë dhe institucionalë, do të ndërmarrë edhe veprime konkrete ligjore në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Projektligji i dorëzuar synon ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ligjore mbi të cilën funksionojnë Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, duke u mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Amendamentin nr. 24 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse dhe Aktgjykimin KO26/15 të Gjykatës Kushtetuese.

Partia Demokratike e Kosovës konsideron se çdo institucion i themeluar me ligjet e Republikës së Kosovës duhet të veprojë në përputhje të plotë me Kushtetutën, ligjet e vendit, standardet ndërkombëtare të

drejtësisë dhe garancitë për një proces të drejtë gjyqësor.

Përmes kësaj nisme, PDK-ja kërkon që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta ushtrojë përgjegjësinë e tij kushtetuese dhe ligjvënëse, duke shqyrtuar me seriozitet dispozitat ligjore që rregullojnë funksionimin e Dhomave të Specializuara.

Hamza ka theksuar se PDK-ja do të vazhdojë të ndjekë çdo rrugë demokratike, institucionale dhe ligjore për të kundërshtuar atë që e konsideron padrejtësi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit dhe për të kërkuar respektimin e plotë të standardeve të drejtësisë në të gjitha fazat e mëtejshme të procesit.

Aleanca, e drejtuar nga Ardian Gjini, ka ritheksuar qëndrimin e saj institucional lidhur me procesin gjyqësor ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë.

Në një deklaratë, Aleanca ka bërë me dije se mbështet çdo iniciativë ligjore dhe demokratike që synon vendosjen e drejtësisë në këtë proces. "Aleanca, duke mbetur konsistente me qëndrimin e saj institucional që nga fillimi, mbështet çdo iniciativë ligjore dhe demokratike që synon vendosjen e drejtësisë në procesin gjyqësor ndaj krerëve të UÇK-së në Hagë", thuhet në deklaratë.

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Partia Demokratike e Kosovës ka dorëzuar të hënën në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Kjo nismë ligjore vjen pas aktgjykimit dënues të Dhomave të Specializuara ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, aktgjykim që Partia Demokratike e Kosovës e ka kundërshtuar publikisht dhe e ka cilësuar si të padrejtë dhe të papranueshëm.

Kryetari i Partisë Demokratike të

Kosovës, Bedri Hamza, në një konferencë për media, ka theksuar se Gjykata Speciale është themeluar për të hetuar pretendimet e raportit të Dick Martyt, prandaj ajo duhet t'i kthehet mandatit mbi të cilin është krijuar. "Në aktakuzat publike të Dhomave të Specializuara nuk është ngritur as edhe një rast lidhur me pretendimet e raportit të Dick Martyt, i cili ka të bëjë me ato akuza aq të rënda. Kjo është arsyeja se pse sot shtrohet një pyetje e thjeshtë: Nëse Kosova e krijoi këtë gjykatë për një mision të posaçëm, a duhet që ky mision të ketë kufij? Projektligji që po paraqitet jep një përgjigje të qartë", tha Hamza. Hamza ka sqaruar qëllimin e ndryshimeve të propozuara në Projektligjin për ndryshimin dhe

NEVOJA EMERGJENTE PËR NJË DISKURS TË RI POLITIK DHE SHTETËROR



Shkruan: Hajdin ABAZI

16 shtatori e trandi Kosovën dhe shqiptarët gjithandej. Një realitet i ri që në të vërtetë ishte krijuar kaherë po që shumëkush edhe pa dashje refuzonim ta shihnim, befas u bë trishtueshëm i qartë, i prekshëm, dhe na e trazoi letargjinë.

Ai na goditi në liri!

Verdikti i Hagës ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kasri Veselit e Rexhep Selimit, pra të katër ish drejtuesve të UÇK-së, u përjetua si shembje e krenarisë, devijim i historisë, si një cunami emocional.

Në fakt, u shemb diçka te ne, në ne. U plandos një iluzion i madh për botën, për miqtë, për aleancat; u shemb një iluzion i perspektivës sonë.

E pra, lufta jonë çlirimtare për liri ishte e pastër si kristali, sepse ajo ishte kundër robërisë, kundër terrorit e gjenocidit të Serbisë, në asnjë mënyrë kundër civilëve serbë a të ndonjë komuniteti tjetër.

Protestat e qytetarëve që shpërthyen gjithandej janë solidaritet, janë identifikim dhe brengë se po njollose lufta e drejtë e UÇK-së e cila qe e vetmja, me organizim minimal e armatim të dobët, u përballë me forcat pushtuese të makinerisë shtetërore të Serbisë. Janë pakënaqësi se përse drejtësia nuk po vepron për mbi 13 mijë civilët, gra, pleq e fëmijë të vrarë përmes dhjetëra masakrave gjithandej Kosovës.

Por ata nuk kanë forcën të bëjnë ndryshime në një çështje aq komplekse, veçse po çojnë sinjale të fuqishme për këtë. Sinjalet i drejtohen politikës, qeverisë. Rrugat mundet vetëm të çojë mesazhe, por shteti është ai që mund të veprojë.

Gjithandej jepen ide se si të veprohet, si duhet bashkuar, çka duhet ndërmarrë. Disa me qëndrime radikale, disa të moderuar. Kjo tregon se më të ndërgjegjshmit janë zgjuar nga letargjia. Mirë shumë. Duket sikur u zbulua shkopi magjik që të ndryshojmë gjendjen. Për fat të

keq, në realitet, nuk ka shkop magjik. Dhe gjendja nuk ndryshohet vetëm pse e thotë sekush.

Që të ndodhë ndryshimi real, duhet krijuar kondita paraprakisht. Çdo ndryshim duhet të nisë para së gjithash nga politikanët, vetëm këta e kanë kapacitetin për të trasuar rrugën me një busull sipas interesit të shtetit. Për të arritur këtu, duhet një ndryshim në veten e vet të atyre që kanë përgjegjësi: të reflektojnë, ta shohin realitetin e ri, të tejkalojnë qasjet e veta të ngushta, t'i lënë anash inatet banale e luftërat për interesa meskine. Kështu, sikurse kemi vepruar deri më tash realisht nuk bëjmë asgjë në funksion të asaj çka duhet e çka lypset as për UÇK-në, e madje as për vetë shtetin.

Për shembull, askush nuk mundet t'i thotë kryeministrit Kurti bëj kështu e bëj ashtu, qoftë si individ, si parti apo si lider. Ai ka fituar zgjedhjet si askush deri më sot me 51%, pra e ka mandatin jashtëzakonisht të fuqishëm nga elektorati për të drejtuar shtetin. Dhe ai, si askush tjetër, e ka përgjegjësinë, sigurisht - po qe se mbështetet nga të gjitha partitë shqiptare. Nëse kjo nuk kuptohet dhe nuk pranohet me konstruktivitet, atëherë zhurmë mund të bëhet, porse nuk mund të shkohet më tutje. Këtu duhet të nis reflektimi dhe ndryshimi i qasjes drejt një kualiteti të ri.

Katër ish-liderët e UÇK-së që u dënuan në Hagë duhet të jenë kambana e alarmit për t'i na zgjuar në ndërgjegje politikanët, jo vetëm për ta, po mbi të gjitha për shtetin tonë, për lirinë tonë. Lufta dhe grindjet inatçore mes partive politike sjellin vetëm dëm. Qe dy vjet - ne e pengojmë veten tonë për të krijuar organet e pushtetit. Ky nuk është interes i shtetit, përkundrazi - është dobësim i tij.

Nëse njëmend i ka zgjuar politikanët 16 shtatori, atëherë duhet të reflektojnë thellë, për hir të lirisë, të shtetit, të së ardhmes sonë.

Liderët e partive duhet të tregohen të guximshëm, vizionarë dhe të kuptojnë se interesat e shtetit mund të sendërtohen vetëm përmes një diskursi racional (sipas Jürgen Habermasit), që i mbivendoset interesave të ngushta partiake. Po qe se është kuptuar serioziteti i situatës, se ne jemi përgjegjës për politikëbërën tonë dhe se vetëm me konstruktivitet reciprok mund të shtojmë fuqinë dhe efikasitetin e veprimit të shtetit, atëherë duhet të bëhet hapi i duhur, i vetmi i drejtë në këto rrethana. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës të votohet presidenti. Këtë duhet ta bëjnë të gjitha partitë, po sidomos PDK-ja. Kështu, do të përcaktohej një kurs i ri parlamentar dhe demokratik i establishmentit politik. Le t'i bartet tërësisht përgjegjësia, atij që ia ka besuar elektorati.

Përtej euforisë, lidhur me Gjykatën Speciale në Hagë, duhet një qasje e ekuilibruar. Inicimi i ndërmarrjeve të pamatura, mund të ketë efekte të kundërta. Për të përcaktuar veprimet e drejta, që njëmend janë efikase, duhet ekspertiza e ekspertëve të mirënjohur ndërkombëtar, duhet lobim në SHBA, në Gjermani, në Britaninë e Madhe dhe po aq në BE. Kjo mund të bëhet vetëm me angazhimin e shtetit, të qeverisë me të gjitha resurset në dispozicion. Për hir të interesave madhore kryeministri Kurti do ta bënte punën e duhur. Jam i bindur se ka mënyra efikase, vetëm se duhet detektuar ato. Këtë duhet ta kemi mësuar nga gabimet e deritashme.

Ideja se jemi tradhtuar nga perëndimorët, sidomos nga SHBA, nuk guxon ta dominojë mendimin politik shqiptar. Ne nuk kemi dhe nuk mund të kemi perspektivë tjetër, në botën e tashme, përveç se me Perëndimin. Por ne duhet të dimë si t'i qasemi perëndimit. Duhet ta njohim filozofinë politike dhe sistemin e të menduarit të tyre, t'i përvetësojmë dhe të sillemi në atë frymë. Nuk mund të jemi properëndimor e njëkohësisht të

rezonojmë në mënyrë ballkanase! Në Perëndim, si në gjithë botën, nuk ka raporte dashurie e aleancash mirëbërësie midis shtetesh: kjo po tregohet shumë qartë tash në raportet SHBA-BE dhe Kanada. Në të vërtetë, ka raporte interesash, të shteteve. Ato i vendosin relacionet, aleancat, kontestet, gjeopolitikat e madje edhe luftërat. Dhe shteti i Kosovës duhet ta identifikojë interesin e vet jetik, dhe atë ta ketë si busull për t'u orientuar në çdo rast, në çdo situatë e rrethanë dhe me secilin shtet, përfshirë vendet Euro-Atlantike. Po qe se politika e Kosovës dhe ajo shqiptare gjithandej do të dijë të manovrojë në konstelacionet sikurse janë këto të viteve të fundit kur po vendoset një rend i ri botëror, do të mund të mbrohen interesat kombëtare në mënyrë të maksimizuar. Nuk ka mbështetje blanko, ka raporte interesash dhe ne duhet t'i shquajmë kur ato ndryshojnë kah e ne të përcaktojmë kursin në favor të shtetit tonë.

Duke shikuar retroaktivisht, shquhen shumë qëndrime që nuk ishin të duhurat. Individët edhe mund të kenë ndonjë besim të tepruar e qëndrime të gabuara, që justifikohet me mungesë informacioni intern. Por institucionet, burrështetarët i kanë ose duhet t'i kenë të gjitha të dhënat, për ndryshimet, konstelacionet midis superfuqive, sepse kanë shërbimet e inteligjencës, rrjetin diplomatik, kontaktet me personalitet prej nga rrjedhin të dhëna. Këta nuk duhet gabojnë. Thjesht, nuk guxojnë! Këshilltarët që angazhojnë duhet të jenë pikërisht për t'i dhënë pikëpamje alternative, këndvështrime dhe konsekuenca nga koniukturat dhe të japin ide konform tyre. Duket se këtu shumëçka nuk ka qenë si duhet. Misioni i institucioneve është që burrështetarët të mos i lënë të bien në lajthitje e gabime. Kjo paska qenë thembra e Akilit

Përtej zhgënjimit, emocioneve,

ndjenjës së braktisjes, pabesisë së aleatëve, mashtrimit, intrigave e prapaskenave, folklorizmit, mentalitetit provincisl - ne duhet të këndellemi. Duhet të ringjallemi si feniksi, veçse nga pluhuri i letargjisë sonë. T'i rishikojmë perceptimet tona: me sinqeritet, me besnikëri ndaj lirisë, me busullën e shtetit, i cili ende nuk është i njohur nga OKB dhe derisa është kjo gjendje rrezikjet ekzistenciale janë si hiena që presin të na gllabërojnë.

Është momentumi kur duhet ndryshuar fryma e komunikimit tonë, e respektit pa kushte të interesit shtetëror, fuqizimit të pozitës sonë ndërkombëtare kundrejt gjeopolitikave në ndryshim e sipër, që të jemi me tërë potencialin në funksion të shtetit, të pavarësisë dhe të lirisë sonë. Të kujtojmë se Serbia provoi më 2023 ushtarakisht ta riokuponte veriun e Kosovës, por me një koordinim të mirë me aleatët - u parandalua në sprovën e parë. Kjo është tregues se lufta me Serbinë ka mbaruar vetëm ushtarakisht, por ajo vazhdon në terrenin politik, diplomatik e gjeopolitik. Nuk e kemi komoditetin që ta injorojmë këtë gjendje, kur ajo është rrezik konstant ndaj ekzistencës sonë si shtet po edhe si shqiptarë: para pak javësh u ripohua synimi për shfarosjen tonë nga kabineti qeveritar i Serbisë.

Ka shumë për t'u thënë, porse po e përmbledhë. Po qe se ne do të kemi vetëdijen kombëtare që të ndryshojmë diskursin politik midis partive, politikanëve, ky do të ishte çelësi i ndryshimit kualitativ për të sotmen e të ardhmen e Kosovës. Ky do të ishte shërbimi më i mirë ndaj atdheut, kombit, shtetit e të lirisë sonë.

Po qe se këtë do ta bëjmë në mënyrën e duhur, më të mirën të mundshme, atëherë do të tregonim se kemi nxjerrë mësimet e duhura nga 16 shtatori.

Kombi shqiptar po i fton politikanët në krye të detyrës. A po e dëgjojnë?!

ORGANIZATORI I PROTESTAVE, ÇLIRIM HAZIRI: DEPUTETËT DUHET TË REAGUJNË, NUK PRESIM DERI NË PAFUNDËSI

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Organizatori i protestave kundër vendimit të Gjykatës Speciale, Çlirim Haziri, ka kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës të reagojnë dhe të angazhohen për ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara. Ai ka paralajmëruar se, nëse nuk ka reagim, protestuesit mund të ndërmarrin veprime të tjera. Në një intervistë për emisionin "Radar" në Radio Dukagjini, Haziri ka thënë se protestuesit nuk do të presin pafundësisht për reagimin e deputetëve. "Sot po presim a po reagon dikush prej deputetëve të Kuvendit të këtij vendi, por nuk do të presim deri në pafundësi. Ne, përveç kërkesës tonë paqësore, nëse do të ketë nevojë, duhet të shkojmë në Kuvend, duhet t'i ftojme deputetët. Ndoshta nuk janë duke na parë, e disa do të na shohin më vonë. Por, çkado që është e nevojshme të bëhet për

historinë tonë kombëtare, për UÇK-në, rinia e Kosovës dhe ata njerëz që po i shohim çdo natë, janë të gatshëm të bëjnë për UÇK-në", ka thënë Haziri. Ai ka theksuar se protestuesit po demonstrojnë në mënyrë dinjitoze dhe se e kanë për obligim të ruajnë vendin dhe institucionet, por ka shtuar se këto institucione nuk mund të konsiderohen të tyre nëse nuk e trajtojnë historinë kombëtare. "Jemi njerëz që po protestojmë dinjitetshëm dhe e kemi obligim ta ruajmë vendin dhe institucionet, por ato nuk mund të jenë tonat nëse nuk e trajtojnë historinë tonë kombëtare. Deputetët kanë nevojë të reflektojnë dhe besoj që kanë për të reflektuar", ka deklaruar ai. Haziri ka thënë se pret reagim nga deputetët shqiptarë të Kuvendit, duke e cilësuar UÇK-në si çështje që i përket të gjithë deputetëve shqiptarë, përveç Listës Serbe.



DELEGACIONI I GRUPIT TË MIQËSISË FRANCË - BALLKANI PERËNDIMOR NË PRISHTINË, DISKUTOHET PËR PJEKJË E KOSOVËS PËR ANËTARËSIM NË BE DHE NATO

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Nënkrjetari i Kuvendit të Kosovës, Ardian Gola, ka pritur në takim një delegacion të Grupit të Miqësisë Francë - Ballkani Perëndimor të Senatit të Republikës së Francës, të kryesuar nga senatorja Marta de Cidrac, presidente e këtij grupi. Në përbërje të delegacionit ishin edhe senatorët Laurence Harribey, Alain Milon dhe Arnaud Bazin, si dhe përfaqësues të Ambasadës së Francës në Kosovë, ambasadori Jean-François Huchet dhe këshilltari i parë, Mar Ivarra, ndërsa delegacioni shoqërohej edhe nga administratori i Senatit, Guillaume Renaudineau. Fillimisht nënkryetari Gola u shprehu mirëseardhje anëtarëve të delegacionit, duke vlerësuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e mirë ndërmjet Kosovës dhe Francës. Ai shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Francës ndaj Kosovës, që nga intervenimi i NATO-s, procesi i shtetndërtimit, e deri te mbështetja në rrugën euroatlantike. Në këtë kuadër, Gola vlerësoi mbështetjen e Francës për liberalizimin e vizave për qytetarët



e Kosovës, si dhe theksoi rëndësinë e heqjes së masave të vendosura ndaj Kosovës në vitin 2023. Nënkrjetari Gola theksoi se prioritet i Kosovës mbetet përpjekja për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe në NATO, duke vlerësuar se integrimi euroatlantik i Kosovës do të kontribuonte në forcimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe më gjërë.

Në këtë kontekst, ai shprehu shqetësimin e tij lidhur me deklaratat e fundit nga zyrtarë të lartë serbë, si ajo e ministres Paunović për spastrimin etnik të Kosovës, retorikën e papranueshme politike të Vuçitit përkitazi me integritetin territorial të Republikës së Kosovës e deri te ceremonitë shtetërore në varrimin e kriminelit të dënuar për krime kundër njerëzimit, Ratko Mladik.

Gola theksoi gjithashtu rëndësinë që Kosova i kushton anëtarësimit në Këshillin e Evropës, tani, siç tha ai, edhe për një arsye të re, për të pasur mundësinë për më shumë qasje në mekanizmat evropianë të drejtësisë, siç është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu që administrimi i proceseve të drejtësisë nga Dhomat e Specializuara në Hagë, të jetë në përputhje të plotë me standardet e drejtësisë.

Duke folur për marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, senatorja Marta de Cidrac falënderoi nënkryetarin Gola për mikpritjen dhe theksoi se Franca ka qenë, është dhe do të vazhdojë të jetë pranë Kosovës në rrugën e saj euroatlantike.

Ajo rikujtoi shkëmbimet e mëhershme ndërmjet dy grupeve të miqësisë dhe theksoi rëndësinë e vazhdimin të kontakteve dhe shkëmbimeve ndërparlamentare ndërmjet Kosovës dhe Francës, si një mundësi për të thelluar bashkëpunimin dhe për të avancuar objektivat e përbashkëta. Në shenjë miqësie dhe respekti, senatorja de Cidrac i dhuroi nënkryetarit Gola Medaljen e Shën Adrianës.

Nënkrjetari Gola vlerësoi vizitën e delegacionit francez dhe theksoi se bashkëpunimi ndërmjet grupeve të miqësisë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Grupi i Miqësisë Francë - Ballkani Perëndimor në Senatën francez përbëhet nga 30 senatorë dhe ka për fokus forcimin e marrëdhënieve ndërparlamentare, diplomacinë parlamentare dhe bashkëpunimin me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Kurti nga SHBA-të: Mërgata dikur sakrifikonte për Kosovën, sot mund të investojë për të fituar

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se për dekada me radhë përmasa e mbështetjes dhe roli i mërgatës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sikurse bashkatdhetarëve gjithandej botës, kanë qenë jetike për mirëqenien si qytetarë dhe triumfin e Kosovës në luftën për

liri dhe angazhimin për shtetndërtim. Këtë deklaratë Kurti i bëri përmes një postimi në rrjetin social në "Facebook" ku ndër të tjera ka shkruar se: "Tash Republika e Kosovës, shtet i pavarur, sovran, demokratik e me zhvillim të qëndrueshëm, ofron mundësi të shkëlqyeshme për investime.

Kësisoj, për dallim nga dekada më parë, tash bashkatdhetarët nuk kanë nevojë të sakrifikojnë për të kontribuar, sepse mund të investojnë për të fituar". Tutje ai ka thënë se në mbrëmjen e organizuar me Data4X dhe Ed e Barbara Hammel në rezidencën e Richard Lukajt në Westchester, me bashkatdhetarë, si dhe investitorë

e politikanë amerikanë, përfshirë ish-kryetarin e Hartfordit, Luke Bronin, biseduan për mundësitë dhe mënyrat konkrete për investime amerikane në Kosovë dhe rolin lehtësues të mërgatës sonë në këtë drejtim. "Republika jonë është partnere në të cilën mund të llogarisin dhe gjejnë mbështetje", ka shkruar Kurti.



Rriten dërgesat e diasporës, Kosova pranon 692 milionë euro gjatë 6 muajve të parë të këtij viti

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Dërgesat e diasporës në Kosovë vazhdojnë të shënojnë rritje të qëndrueshme, duke mbetur një nga shtyllat kryesore mbështetëse për ekonominë e vendit. Sipas të dhënave të fundit nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), të publikuara nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), gjatë periudhës janar-qershor

2026 remitencat arritën vlerën prej 692 milionë eurosh. Kjo shifër përfaqëson një rritje prej 5.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (2025). Më shumë se gjysma e remitencave që hyjnë në Kosovë vijnë nga dy shtete evropiane ku jeton një pjesë e madhe e mërgatës. Gjermania prin bindshëm si

burimi kryesor me 38.2% të totalit të dërgesave. Zvicra renditet e dyta me 20.4% dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) në vendin e tretë me 6.4%. Ndikimi i diasporës në ekonominë vendore ka qenë historikisht i lartë. Të dhënat e BQK-së dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se gjatë periudhës 2008

- 2025, vlera totale e remitencave të pranuar në Kosovë ka kapur shifrën e 15.2 miliardë eurove. Përgjatë dekadës së fundit, dërgesat e mërgimtarëve kanë përfaqësuar vazhdimisht midis 12% dhe 14% të Produktit Brendshëm Bruto (BPV) të Kosovës, duke gjeneruar konsum familjar dhe stabilitet financiar për mijëra familje kosovare.



TREGTIA ME PAKICË RRITET 15.46% NË MUAJIN KORRIK

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën afatshkurtra të tregtisë me pakicë përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave për muajin korrik 2026.

Në muajin korrik 2026, indeksi i qarkullimit të tregtisë me pakicë përveç tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave kishte rritje për 15.46 %, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (korrik 2025). Sipas aktivitetit ekonomik, kishte rritje të: Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara me 46.17 %; Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezgja ose tregje dhe Tregtia me Pakicë jo në dyqane (përmes postës ose internetit) me 37.40 %; Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara me 34.33 %; Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara me 20.40 %; Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara me 20.14 %; Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara me 13.93 %; Tregtia

me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara me 12.89 %; si dhe Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara me 0.49 %.

Indeksi i numrit të të punësuarve

Në muajin korrik 2026, indeksi i numrit të punëtorëve të Tregtisë me Pakicë (përveç Tregtisë së automjeteve dhe motoçikletave) kishte rritje për 5.43 % krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (korrik 2025). Sipas aktivitetit ekonomik, kishte rritje të: Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara me 14.93 %; Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara me 13.93 %; Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara me 9.51 %; Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara me 6.98 %; Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezgja ose tregje dhe Tregtia me Pakicë jo në dyqane (përmes



postes apo internetit) me 6.89 %; Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara me 6.85 %; Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara me 3.25 %.

Indeksi i fondit të pagave dhe mëditjeve

Në muajin korrik 2026, indeksi i fondit të pagave dhe mëditjeve të Tregtisë me Pakicë, përveç Tregtisë

së Automjeteve dhe Motoçikletave kishte rritje për 24.72 %, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (korrik 2025). Sipas aktivitetit ekonomik, kishte rritje të: Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara me 46.81 %; Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara me 38.24 %; Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të

specializuara me 28.16 %; Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara me 27.19 %; Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara me 26.53 %; Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara me 23.44 %; Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezgja ose tregje dhe Tregtia me Pakicë jo në dyqane (përmes postës apo internetit) me 18.96 %; si dhe Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara me 3.01 %.

AKB-ja NË ILO NË GJENEVË: KOSOVA ENDE PA ZË NË ORGANIZATËN BOTËRORE TË PUNËS

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, u prit në selinë e Organizatës Ndërkombëtare të Punës - ILO në Gjenevë, ku zhvilloi një takim me Mito Tsukamoto, drejtues të Employment in Investment (EMPINVEST) në Departamentin e Politikave të Punësimit në ILO. Në takim u diskutua për rolin dhe pozitën e punëdhënësve dhe punëmarrësve në nivel global, me fokus të veçantë në zhvillimet në Kosovë, forcimin e dialogut social, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përfshirjen në të madhe të sektorit privat në politikat e punësimit dhe zhvillimit ekonomik. Një ndër çështjet kryesore të diskutimit ishte perspektiva e

Kosovës dhe mundësitë për pjesëmarrje më të madhe në aktivitetet dhe mekanizmat ndërkombëtarë të ILO-së në të ardhmen. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka prezantuar zhvillimet në Kosovë në fushën e dialogut social dhe Këshillit Ekonomik-Social, duke theksuar rëndësinë e përfaqësimit të denjë të punëdhënësve në proceset vendimmarrëse që lidhen me tregun e punës, ekonominë dhe politikat sociale. Po ashtu, u diskutua për angazhimin ndërkombëtar të AKB-së dhe përfaqësimit në sektorin privat të Kosovës në Evropë, përfshirë angazhimin e AKB-së në mekanizma dhe struktura relevante të Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian -



EESC në Bruksel. “Kosova ka nevojë që zëri i punëdhënësve dhe i sektorit privat të dëgjohet më fuqishëm në nivel evropian dhe

ndërkombëtar. Dialogu social nuk është vetëm çështje e institucioneve vendore, por një standard evropian dhe

ndërkombëtar që ndikon drejtpërdrejt në punësim, investime dhe zhvillim ekonomik”, ka theksuar Shahini. AKB-ja vlerëson se bashkëpunimi me ILO-n dhe institucionet ndërkombëtare të punës është i rëndësishëm për forcimin e pozitës së punëdhënësve të Kosovës, avancimin e dialogut social, krijimin e vendeve të reja të punës dhe integrimin e sektorit privat të Kosovës në rrjetet evropiane dhe globale. Ai ka thënë se Aleanca Kosovare e Bizneseve do të vazhdojë angazhimin e saj për përfaqësimin e interesave të komunitetit të biznesit të Kosovës dhe ngritjen e zërit të punëdhënësve në institucionet evropiane dhe ndërkombëtare.

Skema e shtesave për fëmijë kishte numrin më të madh të përfituesve gjatë gushtit

Prishtinë, 21 shtator- Skema e shtesave për fëmijë kishte numrin më të madh të përfituesve gjatë gushtit 2026. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), nga kjo skemë

përfituan 374 mijë e 382 fëmijë. Për pagesat e tyre u ndanë mbi 13.5 milionë euro. Pas saj renditet skema e pensioneve bazike të moshës, me 171 mijë e 45 përfitues. Për

këtë kategori u shpenzuan mbi 27.1 milionë euro. Pensionet kontributpaguese të moshës përfshinë 47 mijë e 841 përfitues. Vlera e pagesave arriti në mbi 11.7 milionë euro.

Nga skema për veteranët përfituan 39 mijë e 646 persona. Për pagesat e tyre u shpenzuan mbi 7.8 milionë euro. Ndërkaq, 21 mijë e 655 persona përfituan pensione për personat

me aftësi të kufizuara. Shuma e ndarë ishte mbi 3.6 milionë euro. Skema e ndihmës sociale përfshiu 14 mijë e 789 përfitues. Për këtë kategori u paguan mbi 2.1 milionë euro.

SA AFËR ËSHTË NJË PËRSHKALLËZIM RUSI-NATO? INTELIGJENCA EUROPIANE FLET PËR “MUAJ, JO VITE”

Zyrtarë të inteligjencës evropiane kanë ngritur shqetësimin se Rusia mund të ndërmarrë një “test” ndaj NATO-s në muajt e ardhshëm, duke paralajmëruar se një përshkallëzim i mundshëm mund të ndodhë “pas muajsh, jo pas vitesh”. Paralajmërimi vjen në një kohë kur lufta në Ukrainë po i afrohet dimrit të pestë dhe kur sulmet me dronë e raketa mes Rusisë dhe Ukrainës janë intensifikuar.

